



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	21.02.2024
REFERENC-Ë:	18/1891/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Fortesa" N.P.T. Studenicë, Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për pëlqimit mjedisor

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, bazuar në Aktgjykimin K.Dh.Sh.II nr. 857/2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, dhoma e shkallës II, me të cilën është refuzuar si e pabazuar ankesa e MMPHI-së dhe është vërtetuar Aktgjykimi KA. Nr. 1068/22 ka shqyrtuar Aktgjykimin KA. Nr. 1068/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, lidhur me konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "Fortesa" N.P.T. Studenicë, Istog në lidhje me Vendimin Nr. 18/1891/1-242/DMMU të datës 12.10.2018 për refuzimin e Pëlqimit Mjedisor për fermën e pulave në Studenicë, Komuna e Istogut. Pas shqyrtimit të aktvendimit KA. Nr. 1068/22 ku Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "Fortesa" N.P.T. Studenicë, Istog dhe Anulohet Vendimi Nr. 18/1891/1-242/DMMU i datës 12.10.2018 i të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe e njejta obligohet që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi ta pajisë me Pëlqim Mjedisor paditësin "Fortesa" N.P.T. Studenicë, Istog për ushtrimin e veprimtarisë për fermën e pulave në Studenicë, Komuna e Istogut me arsyetimin se i padituri nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike.

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentit Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe të Nenit 131 dhe 132 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nxjerr këtë:

Vendim

APROVOHET kërkesa e Kompanisë “Fortesa” N.P.T. Studenicë, Istog për ushtrimin e veprimtarisë për fermën e pulave në Studenicë, Komuna e Istogut.


A r s y e t i m

Bazuar në Aktgjykimin KA. Nr. 1068/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, ku Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Fortesa” N.P.T. Studenicë, Istog dhe Anulohet Vendimi Nr. 18/1891/1-242/DMMU i datës 12.10.2018 i të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe e njehta obligohet që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtijë Aktgjykimi ta pajisë me Pëlqim Mjedisor paditësin “Fortesa” N.P.T. Studenicë, Istog për ushtrimin e veprimtarisë për fermën e pulave në Studenicë, Komuna e Istogut me arsyetimin se i padituri nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, MMPHI

Faqe 2 nga 4

APROVON kërkesa e Kompanisë " Fortesa" N.P.T. Studenicë , Istog për ushtrimin e veprimtarisë për fermën e pulave në Studenicë, Komuna e Istogut nën këto kushte:

- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e të zeza dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operationale gjatë të reshurave, (seperatori për vajra, yndyra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit.
- Të betonohet (asfaltohet) dhe izolohet platoja e sipërfaqeve operationale në afërsi të objektit.
- Të betonohet dhe thuret me mur platoja për vendosjen plehrave të pulave dhe të mbulohet
- Të parashihet reduktimi i aromës së pakëndshme në një masë me anë të filtrave dhe përmes riqarkullimit të ajrit.
- Të instalohet Sistemi i Biofilterëve.
- Të bëhet izolimi dhe ventilimi i të gjitha burimeve të emisioneve të aromës së pakëndshme.
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3 , me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e kompanisë "Fortesa" N.P.T. Studenicë, Istog në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.



Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 18/1891/1 - ZSP/ /24 datë: 21.02.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Zyrës për Informim
4. Zyrës Ligjore
5. Inspektoratit
6. Kabinetit të Ministrit
7. Arkivit të MMPHI
8. Komunës së Istogut

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm
të MMPHI



Faqe 4 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net